



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Raportimi në Komisionin për Ekonominë dhe Financat – Veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2020

I nderuar Z. Kryetar i Komisionit,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, anëtarë të Komisionit,

Fillimisht, më lejoni t'ju falenderoj për mundësinë për të prezantuar në një kohë të shpejtë Raportin Vjetor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Viti 2020 ishte një vit i vështirë dhe tejet i pazakontë, pasi pasojat e gjithanshme të pandemisë, të cilat sollën ndikime edhe në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, si edhe efekti vazhdues i dëmeve të tërmeteve të fundvitit 2019, ishin dy elementë me ndikim kryesor jo vetëm për shoqëritë që operojnë në tregjet financiare, por edhe për vetë Autoritetin.

Tregjet nën mbikëqyrje shfaqën rezistencë gjatë 2020 ndaj efekteve të pandemisë dhe paraqiten të qëndrueshëm, me tregues të mirë të likuiditetit e të shëndetit financiar, si edhe të mbulimit me provigjone. Totali i aseteve në këto tregje në fund të vitit 2020 u rrit me 1.5%, duke arritur në rreth 110 miliardë lekë, ose 6.8% e PBB-së, kundrejt 6.5% që ishte në vitin 2019. Gjithashtu, konstatojmë se tregu i sigurimeve e përballoi me sukses faturën financiare të dëmeve të tërmeteve të fundvitit 2019, ku 90% e praktikave të dëmshpërblimit janë paguar brenda vitit 2020.

Vlen të theksohet se bazuar në shifrat e 3-mujorit të parë të këtij viti, tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së po i kthehen normalitetit. Sipas të dhënave paraprake, tregu i sigurimeve ka njohur një rritje me 12.5% të të ardhurave për janar-marsin e këtij viti, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa tregu i fondeve të investimit ka një rritje me 2.4% të vlerës së aseteve neto për 3-mujorin e parë të vitit 2021, krahasuar me 3-mujorin e fundit të vitit të kaluar.

Gjatë vitit 2020, Autoriteti ndërmori një sërë masash në funksion të garantimit të stabilitetit financiar, ruajtjes së qëndrueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje dhe treguesve të operatorëve që veprojnë në këto tregje. Më konkretisht, Autoriteti monitoroi treguesit e likuiditetit të shoqërive të sigurimit dhe të shlyerjeve neto nga fondet e investimeve. Në linjë me rekomandimet e rregullatorëve evropianë, u kërkoi shoqërive të tregjeve nën mbikëqyrje që të përditësojnë dhe të kenë funksionale planet e vijimësisë së veprimtarisë dhe planet e përballimit të krizave, ndërkohë që rishikoi dhe miratoi planin e tij të vazhdimësisë së aktivitetit në raste të jashtëzakonshme. Për ruajtjen e gjendjes së likuiditetit, me vendim të Autoritetit, u pezullua shpërndarja e dividendit për shoqëritë e sigurimit. Dhe ndërkohë, Bordi miratoi një udhëzim të posaçëm për shoqëritë e tregjeve nën mbikëqyrje, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë, si edhe rritjen e transparencës në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe investitorit.

Sa i përket aspektit ligjor dhe rregulator, pas miratimit vitin e kaluar nga Kuvendi i Shqipërisë të tre ligjeve kyçe që rregullojnë fushën e shërbimeve financiare në tregun e kapitaleve dhe atë të fondeve, Autoriteti përgjatë 6-mujorit të dytë u angazhua në hartimin dhe miratimin e disa rregulloreve në zbatim të këtyre ligjeve. Aktualisht, po vijohet me hartimin e akteve të tjera nënligjore, për të cilat Autoriteti po asistohet nga ekspertiza e Bankës Botërore.

Ligjet e reja të miratuara përafrojnë kuadrin ligjor të këtyre tregjeve me direktivat evropiane dhe legjislacionet në fuqi në shtetet e Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, Autoriteti është angazhuar edhe në përshtatjen e Ligjit “Për fondet e pensionit vullnetar” me qëllim që jo vetëm të kemi një përafrim me kuadrin ligjor evropian, por nxitje dhe zhvillim të tregut të pensioneve private. Brenda këtij viti parashikohet që ndryshimet t’i përcillen Këshillit të Ministrave.

Përgjatë vitit 2020, Autoriteti ka realizuar përmirësime në rregullore që lidhen me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Një pjesë e masave, qoftë rregullative, qoftë edhe masave të tjera, edhe nëpërmjet inspektimeve janë marrë në zbatim të rekomandimeve të Komitetit të MONEYVAL-it. Përgjithësisht, raporti i MONEYVAL përmban vlerësime për punën e bërë nga Autoriteti dhe tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit kategorizohen me nivel të ulët rreziku.

Në drejtim të plotësimit të rekomandimeve të Komisionit Evropian, miratimi përfundimtar javën e kaluar i ligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” nga Kuvendi i Shqipërisë konsiderohet një zhvillim i rëndësishëm. Ky ligj pritet të përmirësojë disa aspekte të funksionimit dhe rregullimit të tregut të sigurimeve, duke parashikuar më konkretisht:

- Përfshirjen për herë të parë të “Raportit European të Aksidenteve”;
- Rritjen graduale të shtrirë në kohë të limiteve të përgjegjësisë;
- Përfshirjen e faktorëve të riskut në tarifimin nga shoqëritë e sigurimit;
- Uljen e afateve të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim për një sërë kategori dëmsh;
- Mënyrën e re të trajtimit të dëmeve Fond Kompensimi, ku parashikohet përfshirja e shoqërisë së sigurimit (si sigurues i drejtëpërdrejtë), duke kryer funksionet e entit kompensues (BSHS);
- Kufizimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim nga shoqëritë e sigurimit.

Në vijim po ndalem në disa të dhëna më të detajuara të tregjeve nën mbikëqyrje përgjatë vitit 2020.

Tregu i sigurimeve, pavarësisht efekteve të pandemisë që solli rënie të të ardhurave me 5.73%, si edhe pagesës së dëmeve të tërmetit, paraqitet në fund të vitit 2020 likuid, me rritje të aftësisë paguese, si edhe me rritje të mbulimit me provigjone.

Kështu, në fund të vitit 2020, tregu i sigurimeve rriti kapitalet e veta me 1.84 miliardë lekë krahasuar

me një vit më parë. Treguesi i aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës ka pësuar një rritje të konsiderueshme, në masën 67%, krahasuar me vitin 2019. Ky ndryshim vjen edhe si rezultat i planit të veprimit të miratuar nga Bordi i Autoritetit me sens rimëkëmbjeje për 2 shoqëri sigurimi. Gjithashtu, gjatë dy viteve të fundit, aktivet e tregut të sigurimeve kanë pësuar një rritje të konsiderueshme me rreth 25%. Rritja e aktiveve është shoqëruar me rritje të investimeve, sidomos gjatë vitit të kaluar, në masën 13.6% krahasuar me një vit më parë.

Tregu i sigurimeve ka shënuar përmirësime edhe në treguesin e aktiveve në mbulim të provigjoneve. Gjithashtu ka patur përmirësim edhe në raportin provigjone/prime të shkruara bruto në nivel tregu duke arritur në 126.4%, evidentuar si një tregues i mirë edhe në raportin e fundit të Bankës Botërore, i publikuar në dhjetor të vitit të kaluar.

Totali i dëmeve të paguara bruto, arriti në 7.5 miliardë lekë ose 17.4% më shumë se në vitin 2019. Rritja e konsiderueshme e dëmeve të paguara bruto erdhi kryesisht si pasojë e pagesës së dëmeve të tërmeteve. Kështu, nga shoqëritë e sigurimit vetëm përgjatë vitit të kaluar janë paguar rreth 3 miliardë lekë dëme për tërmetin. Gjithashtu, vlen të theksohet se vetëm 6 çështje rezultojnë në fund të vitit 2020 të ankmuara në gjykatë, një shifër kjo e papërfillshme marrë në konsideratë se shoqëritë e sigurimit kanë trajtuar 6295 kërkesa për dëmshpërblim në lidhje me dy ngjarjet e tërmetit të fundvitit 2019.

Në lidhje me Fondin e Kompensimit, Autoriteti vijoi monitorimin e kujdesshëm me qëllim saktësinë e të dhënave të raportuara në sistemin elektronik të dëmeve, respektimin e afatave për kryerjen e pagesave si dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Gjatë vitit 2020 u paguan rreth 369 milionë lekë dëmshpërblime me objekt Fondin e Kompensimit.

Tregu i fondeve të investimeve, i cili u përball me rritje të shlyerjeve neto negative në 3-mujorin e dytë të vitit 2020 si pasojë e efekteve të pandemisë, rikuperoi në 6-mujorin e dytë dhe e mbylli vitin me një rritje prej 0.9% në vlerë asetesh, duke arritur në 67.4 miliardë lekë. Gjithashtu, edhe numri i anëtarëve në fondet e investimeve ka njohur rritje.

Rritje shënoi edhe **tregu i fondeve të pensioneve private**, si në total asetesh, ashtu edhe në numër anëtarësh. Kështu, totali i asetëve u rrit me 23.8%, duke arritur në 3.6 miliardë lekë. Ndërsa numri i anëtarëve u rrit me 9.7%, duke arritur në 31,020 anëtarë. Megjithatë, vlera neto e asetëve të këtij tregu është modeste dhe potenciali për zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu është i konsiderueshëm.

Tregu i kapitaleve mbeti i përqendruar te tregu i titujve të Qeverisë dhe tregu i obligacioneve private. Segmenti i fundit njohu një dinamikë në rritje përgjatë vitit 2020. Kështu, volumi i obligacioneve me ofertë private të pamaturuara u rrit me 7.7%, duke arritur në rreth 8 miliardë lekë në fund të vitit 2020. Sa i përket aktivitetit të Bursës Shqiptare të Titujve ALSE, vlera e tregtimit për vitin 2020 ishte rreth 452 milionë lekë, ku dominuan sërish transaksionet e kryera midis bankave për llogari të tyre dhe për llogari të personave juridikë. Tregu i kapitaleve është i plotësuar edhe me infrastrukturën e pastregtimit, nëpërmjet licencimit të shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve” (ALREG) për kryerjen e funksionit të klerimit dhe shlyerjes së titujve joqeveritarë që tregtohen në Bursë, por edhe me funksionin e depozitarit qëndror.

Ndër veprimet e tjera, Autoriteti vijoi monitorimin e tregut financiar nëpërmjet inspektimeve në vend dhe atyre nga distanca. Në total janë zhvilluar 41 inspektime në vend dhe janë marrë një sërë masash me qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit. Gjatë vitit 2020 u përmirësuan më tej dy sistemet e raportimit të shoqërive të tregjeve nën mbikëqyrje në Autoritet. Gjithashtu u realizua përshtatja e plotë e Regjistrimit Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik me sistemet e reja të institucioneve me të cilat bashkëvepron sistemi i AMF-së. Në kuadër të digjitalizimit të shërbimeve synohet ofrimi i disa shërbimeve për qytetarët nëpërmjet platformës e-Albania.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Edhe pse treguesit e muajve të parë të këtij viti sugjerojnë një kthesë drejt rimëkëmbjes së aktivitetit të sektorit nën mbikëqyrjen e AMF-së, përsëri sfida për garantimin e stabilitetit, qoftë për Autoritetin, por edhe për vijueshmërinë e veprimtarisë mbetet prezente. Autoriteti do të vijojë të monitorojë në vazhdimësi treguesit e likuiditetit të shoqërive të sigurimit, si edhe shlyerjet neto të fondeve të investimeve, duke marrë masat e nevojshme rregullatore në funksion të ruajtjes së shëndetit financiar të tregjeve dhe mbrojtjes së konsumatorit e investitorit.

Autoriteti do të vijojë angazhimin për plotësimin e kuadrit rregullator në zbatim të ligjeve të reja të miratuara. Gjatë vitit 2021 pritet të realizohet hartimi dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore, gjë që pritet të sjellë jo vetëm një rregullim më të mirë të tregjeve nën mbikëqyrje, por edhe të krijojë mundësi të reja për zhvillimin e tyre.

Përmirësimi i mëtejshëm i praktikave mbikëqyrëse dhe avancimi drejt mbikëqyrjes së plotë me fokus rrezikun mbetet një prioritet i Autoritetit. Gjithashtu synohet përparimi i mëtejshëm drejt parimeve themelore ndëkombëtare në sigurime (ICP), si një kornizë e gjithëpranuar për mbikëqyrjen efektive dhe me standarde të larta të tregut të sigurimeve. Përdorimi i teknologjisë dhe modernizimi i sistemeve të raportimit në funksion të rritjes së efikasitetit në proceset mbikëqyrëse do të jenë në fokus të veprimtarisë së Autoritetit gjatë këtij viti dhe në vijim.

Faleminderit!